

VENDIM
Nr. 1044, datë 16.12.2015

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA ZBATIMI I MARRËVESHJES ME SHKËMBIM NOTASH, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE REPUBLIKËS POPULLORE TË KINËS, “MBI RECIPROCITETIN E GODINAVE KU AKOMODOHEN PËRFAQËSIA DIPLOMATIKE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, NË PEKIN, DHE PËRFAQËSIA DIPLOMATIKE E REPUBLIKËS POPULLORE TË KINËS, NË TIRANË”, NËNSHKRUAR MË 10.4.1960

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 8, shkronja “a”, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, dhe të ligjit nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preken nga zbatimi i marrëveshjes me shkëmbim notash, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Popullore të Kinës, “Mbi reciprocitetin e godinave ku akomodohen përfaqësia diplomatike e Republikës së Shqipërisë, në Pekin, dhe përfaqësia diplomatike e Republikës Popullore të Kinës, në Tiranë”, nënshkruar më 10.4.1960.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Ministrisë së Punëve të Jashtme.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasurinë tokë “truall”, me sipërfaqe 8 223.8 (tetë mijë e dyqind e njëzet e tre pikë tetë) m², dhe vlerë 197 001 129.5 (njëqind e nëntëdhjetë e shtatë milionë e një mijë e njëqind e njëzet e nëntë pikë pesë) lekë.

4. Vlera e shpronësimit, prej 197 001 129.5 (njëqind e nëntëdhjetë e shtatë milionë e një mijë e njëqind e njëzet e nëntë pikë pesë) lekësh, të përballohet nga llogaria e Ministrisë së Financave, në Bankën e Shqipërisë, zëri “Fondi i shpronësimeve”, për vitin 2016.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 800 000 (tetëqind mijë) lekë, të përballohen nga Ministria e Punëve të Jashtme.

6. Likuidimi i pronarëve të fillojë pas çeljes së fondit të përcaktuar në pikën 4, të këtij vendimi.

7. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve, nga data e miratimit të këtij vendimi, Ministria e Punëve të Jashtme, në bashkëpunim me Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, të kryejnë regjistrimin e pasurisë së cituar në pikën 1, në favor të Ministrisë së Punëve të Jashtme.

8. Pronarët e pasurive, për të cilat është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZVRPP-ja”, të likuidohen, për efekt shpronësimi, në bazë të dokumentacionit të plotë të pronësisë që do të dorëzojnë pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme.

9. Ngarkohen Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Financave, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

DATA BASE E PRONAREVE DHE MASA E SHPERBLIMIT PER PASURITE E PALUAJTSHME

TE DHENAT E PRONARIT DHE TE PASURISE SE PALUAJTSHME (sipas konfirmimit te ZVRPP-se)										TE DHENAT E POSEDUESIT								TE DHENAT PER SHPERBLIMIT			
NR.	EMER	ATESI	MEMBER	STATUSI JURIDIK			SIP. E PRONES SIPAS HARTES VEKTOR (m ²)	ZONA KADASTRALE	NUMRI I PASURISE	NR. I SUBJEKTEVE	EMER	ATESI	MEMBER	NUMRI I PASURISE	SIPERFACIA E PARCELES QE ESHTJE BERE KALIM I PRONESIE (m ²)	Miratuar per Kalim Pronesie me Vlerë nr. dt.	Data e Miratimit	SIPERFACIA TAUJESHE PER KOMPESIM	VENDODHJA E PASURISE KADASTRALE (ZONA)	VLERJA E TREGUT PER TRUALL (Lekë/m ²)	VLERJA E SHPERBLIMIT (Lekë)
				NR. PROTOKOLLIT	DATE E LESHIMIT	SIPERFACIA E PRONES (m ²)															
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	19	20	21	22	23	24
1	LLAQI	LLUK	ÇETRI	19944/1	18.11.2014	12877.61	12877.6	8250	1/944	1	AMBASADA E REPUBLIKES POPULLORE TE KINES				9000	67	28.01.2015	5440.3	8250	23.955	130,322,387
2	LLAQI	LLUK	ÇETRI	10248/2	14.07.2015	2440.19	2440.19	8250	1/946	1	AMBASADA E REPUBLIKES POPULLORE TE KINES				9000	67	28.01.2015	2001.2	8250	23.955	47,938,746
3	AGIM FATIKA NADIRE NIMETE SHPETIM	ISLAM MIHAL ISLAM ISLAM SELMAN	PAJA QINAMI SHEHU DEVAJA QINAMI	10248/2	14.07.2015	761.32	761.32	8250	1/947	1	AMBASADA E REPUBLIKES POPULLORE TE KINES				9000	67	28.01.2015	708.6	8250	23.955	16,974,513
3	AGIM FATIKA NADIRE NIMETE SHPETIM	ISLAM MIHAL ISLAM ISLAM SELMAN	PAJA QINAMI SHEHU DEVAJA QINAMI	10248/2	14.07.2015	78.7	78.7	8250	1/160	1	AMBASADA E REPUBLIKES POPULLORE TE KINES				9000	67	28.01.2015	73.7	8250	23.955	1,765,483.5
																		8223.8			197001129.50
																		SIP. TOTALE (m ²)			VLERJA TOTALE (LEKE)